

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Nr. 310 prot

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE

Nr. 1381 prot 10.3.11

UDHËZIM

Nr. 2 datë 18.01.2011

PËR

“PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË KRYEN AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË”

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 60, nenit 61 dhe nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të nenit 14 të Vendimit nr. 424, datë 02.06.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë” i ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave,

UDHËZOJMË:

1. Tarifa për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), nga ekspertët e jashtëm, vendas ose të huaj dhe konsulentët, për vlerësimin e aplikimit dhe paraakreditimit të jenë si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| a) Vlerësimi i aplikimit dhe paraakreditimi <u>institucional</u> për hapjen e Institutit të Arsimit të Lartë | 2 000 000 lekë |
| b) Vlerësimi i aplikimit dhe paraakreditimi institucional për hapjen e filialit ose njësisë kryesore | 1 500 000 lekë |
| c) Vlerësimi i aplikimit dhe paraakreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të parë | 400 000 lekë |
| c) Vlerësimi i aplikimit dhe paraakreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të dytë | 600 000 lekë ↔ |
| d) Vlerësimi i aplikimit dhe paraakreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të tretë | 800 000 lekë |

7 Fyq. shkollës së D1
nr. 2328/1 datë 16
dëni nr. 6 p.p.m.a

2. Tarifa për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), nga ekspertët e jashtëm, vendas ose të huaj dhe konsulentët, për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin të jenë si më poshtë:

a) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi institucional i Institucionit të Arsimit të Lartë	4 000 000 lekë
b) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi institucional i filialit ose njësisë kryesore	3 000 000 lekë
c) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi institucional i një programi të ri studimi të ciklit të parë	600 000 lekë
c) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi institucional i një programi të ri studimi të ciklit të dytë	800 000 lekë
d) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi institucional i një programi të ri studimi të ciklit të tretë	1 000 000 lekë

3. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikës 1 dhe pikës 2 të këtij udhëzimi, arkëtohen para procesit të vlerësimit, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të postës shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

4. Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë shpërndahen 10% në Buxhetin e Shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë.

5. Pjesa e të ardhurave që i takon Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë evidentohen, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 06, "Të ardhurat jashtë limitit".

6. Të ardhurat që sigurohen nga këto shërbime për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë përdoren si më poshtë:


- për pagesën e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, dhe konsulentëve, të cilat janë kontraktuar nga APAAL;
- për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Këshillit të Akreditimit;
- për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucioneve ndërkombëtare;
- për pagesën e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit dhe shpenzimet e tjera të tij;

7. Udhëzimi nr. 4, datë 28. 02. 2006 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike", shfuqizohet.


8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS



MINISTRI I FINANCEVE



→ Bata e 4 prill 2011